

Kalon vetingun gjyqtarja Blerona Hasa

Nga [Exit News](#) 27-07-2020 në 09:28



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka konfirmuar të hënën në detyrë gjyqtaren e Gjykatës Administrative të Apelit Blerona Hasa.

Vendimi u mor nga Olsi Komici, Brunilda Bekteshi dhe Xhensila Pine.

Gjatë seancës së 23 korrikut, KPK deklaroi se kishte gjetur disa pasaktësi në deklarin e pasurisë së gjyqtares.

Sipas relatores Brunilda Bekteshi, kishte mospërputhje mes të dhënave të pasqyruara në deklaratën veting nga gjyqtarja Hasa dhe dokumentacionit të administruar nga institucionet për ndërtimin e një kati banimi dhe papafingoje në pjesën e sipërme të një shtëpie në Durrës.

Bekteshi tha se 'nga kryerja e analizës financiare duket se subjekti i vlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në vlerën 6.1 milionë lekë për kryerjen e investimeve për banesën dhe shpenzimet familjare.'

Gjyqtarja Hasa i kundërshtoi gjetjet e KPK-së dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.